

“Krijimi i sistemit te menaxhimit dhe monitorimit mjedisor ne linje me raportimet globale”



Kordinatore: Odeta Cato



Empowered lives.
Resilient nations.

Tre fushat kontribuuese që korrespondojnë me rezultatet e pritura sipas strategjisë së projektit përfshijnë punën në tre fushat e mëposhtme:

- Zhvillimi i një EIMMS që do të jetë në gjendje të integrojë angazhimet globale të mjedisit në proceset e planifikimit dhe monitorimit;
- Zhvillimi dhe aplikimi i treguesve standardë që përfshijnë tre konventat e Rio-s : UNFCCC, CBD dhe CCD
- Përmirësimi i kapaciteteve të palëve të interesuara për menaxhimin e informacionit (grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave) dhe shfrytëzimi i informacionit (interpretim dhe raportim) në nivel kombëtar dhe lokal.



Vlerësimi i Kapaciteteve Kombëtare të Shqipërisë për Monitorimin e Mjedisit

-Mungesa e treguesve të zhvillimit dhe reagimit të lidhura me hartimin e politikave mjedisore.

-Vlerësimi i buxhetit për monitorim:

Zbatimi i plote i planit të monitorimit kombëtar të 158 indikatorëve mjedisore për një periudhë 6 vjecare:

(pa llogaritur ndonjë nevojë për laboratore)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Unit: Euro
Establishment of a GIS based monitoring IS	175,960	263,940					439,900
Data Development							0
Climate Change	160,500	145,500	145,500	85,500			537,000
Air Pollution	358,790	210,790	210,790	210,790	210,790	210,790	1,412,740
Waters, surface and underground	428,509	413,509	413,509	413,509	413,509	413,509	2,496,054
Biodiversity		660,000	660,000	660,000			1,980,000
Forestry	255,000		25,500		25,500		306,000
Waste							0
Quality policy protocols and training	70,000	59,000					129,000
	1,448,759	1,752,739	1,455,299	1,396,799	649,799	624,299	7,300,694



Monitorimi dhe vlerësimi i indikatoreve hidrologjike, problematikat aktuale dhe rekomandime

Konsulent: Prof. Dr. Molnar Kolaneci

An aerial photograph of a river, likely the Tisza, showing a large dam or bridge structure in the background. The water is a deep blue-green color, and the surrounding landscape is a mix of green and brown. The text is overlaid on the lower left portion of the image.

Standartet Nderkombetare

Bazat ne Organizates Boterore te Meteorologjise dhe Direktiven e Ujit

Monitorimi i hidrologjik ne lumenj, liqene dhe dete

- Bazohet ne: "Standardet dhe Udhezimet e OBM" si edhe ne Direktiven e Ujit 2000/60/EC – kuadri per veprimet e Komunitetit ne fushen e politikave te ujit

Qëllimi i kësaj direktive:

- Vendos rregullat per te ndaluar përkeqësimin në statusin e trupave ujqorë të Bashkimit Evropian (BE) dhe për të arritur "status të mirë" për lumenjtë, liqenet dhe ujërat nëntokësore të Evropës

Në mënyrë specifike kjo përfshin:

- mbrojtjen e te gjithë formave te ujit (siperfaqesorë, nëntokësorë etj);
- rikthimin e ekosistemeve në dhe rreth këtyre trupave ujqorë;
- reduktimin e ndotjes në trupat ujqorë;
- duke garantuar përdorimin e qëndrueshëm të ujit nga individët dhe bizneset

Shqipëria pavarësisht se nuk është vend i BE e ka përqaftuar këte Direktive Evropiane dhe është duke e zbatuar si në kuadrin ligjor ashtu dhe në praktiken e përditshme.

Monitorimi i hidrologjik ne lumenj, liqene dhe dete

- Nga ana teknike OBM pergjigjet per gjithe metodologjite, standardet dhe udhezimet se si duhet kryer monitorimi i ujerave duke perfshire dhe format e ndryshme te organizimit institucional.
- OBM ka publikuar dhe vazhdon te publikojë shumë studime, udhëzime, rregullore teknike, manuale, etj., të cilat janë një mbështetje e madhe për Shërbimet Hidrologjike, të cilat merren me monitorimin hidrologjik të një vendi.
- Ne Shqiperi si edhe ne shume vende te Evropes kete aktivitet e ka kryer Instituti Hidrometeorologjik dhe drejtuesit e ketij institucioni kane qene Perfaqesuesit e Shqiperise ne OBM.

Standardet hidrologjike dhe praktikat e rekomanduara të monitorimi hidrologjik



Stacioni hidrometrik :

Monitorimet hidrologjike kryhen ne nje vendmatje (stacion) hidrometrike që ndodhen në të gjithë objektet ujore

Në një stacion hidrometrik duhet të bëhen vërtetimet për disa ose të gjitha elementet e mëposhtme:

- Niveli i ujit të lumit, liqenit ose rezervuarit, detit;
- Rrjedhja (prurje);
- Transporti dhe/ose depozitimi i sedimenteve;
- Temperaturat dhe vetitë fizike të ujit të lumit, liqenit ose rezervuarit;
- Vetitë kimike dhe biologjike të ujit të lumit, liqenit ose rezervuarit

Regjistrimi i nivelit të ujit

behët me anë vërtetimi sistematik në rastin e një hidrometri (vendosur në breg të objektit ujor ose me anë të një pajisjeje veterregjistruese).



Matja e sedimenteve (lenda e ngurte)

Transporti i sedimenteve llogaritet edhe me formula te ndryshme hidraulike qe bazohen ne kerkime laboratorike. Por duhet thene se saktesia e ketyre formulave le shumë për të deshruar dhe gabimet shkojne deri ne 200%.

Ekzistojne edhe disa formula te thjeshta empirike qe shprehin sasine e lendes se ngurte fundore ne varesi te sasise se lendes pezull. Kjo perqindje luhetet nga 10% ne zonat fushore dhe shkon deri ne 50% ne zonat malore.

Monitorimi i vetite fiziko- kimike dhe biologjike

Disa nga keto parametra maten direkt ne terren duke perdorur sonda multiparametrike

Disa parametra te tjere kerkojne marrjen e kampioneve dhe analizimin e tyre ne laboratore.

Ka pajisje qe montohen ne stacionet hidrometrike te cilet mundesojne matjen e disa parametrave fiziko-kimike ne menyre te vazhdueshme automatike.

Trainimet ne hidrologji

Zakonisht njihen tre kategori te personelit:

Hidrolog profesionist

Teknik hidrolog

Vrojtuës hidrometrik

OBM boton vazhdimisht publikime per menyren se si duhet te trainohen keto kategori ekspertesh

Gjendja e monitorimit të lumenjve në Shqipëri



Në kuadrin e këtij projekti një nga detyrat ka qene njohja e gjendjes se stacioneve te monitorimit ne shtate lumenjte kryesore te vendit.

Ne vazhdim do paraqesim Lumin Seman dhe Lumin Vjose

Lumi Vjose

- Është lumi i dyte në vendin tonë persa i përket ujëshmërisë.
- Ka një periudhe mbi 10 vjeçare që lumi Vjosa del nga shtrati në pjesën fundore të tij duke krijuar permbytje dhe deme të konsiderueshme në gjithë fshatrat që e rrethojnë.
- Lumi Vjosa në rrjetin kombëtar hidrologjik kërkon vëmendje me te larte ne monitorim dhe paisje.
- Paisjet veterregjistruese nuk kane funksionim te rregullt dhe matjet jane kryesisht manual.

Vendmatja Vjosa në Urën e Mifolit 40°38'2.52"N, 19°27'39.39"E

Stacion fundor i Vjoses, paraqet interes vetem per nivelet e ujit, ndersa per matjet e prurjes ka ndikim batice- zbatice dhe nuk behen matje prurje.



Lumi Vjose

Memaliaj

Vjosa në Memaliaj, 2018 – Një pajisje veterregjistruese



Shenim
manual



Lumi Seman

Seman Ura e Kuçit, $40^{\circ}50'41.53''\text{N}$, $19^{\circ}48'16.48''\text{E}$



Shenim manual

**Semani Ura e Mbrostarit,
40°45'1.66"N, 19°34'39.18"E**



Rekomandime

- Rehabilitimi i Rrjetit Hidrologjik Kombëtar
- Një rishikim i plotë i praktikave operacionale dhe rezultateve të të gjitha stacioneve matëse në të gjithë basenet e vendit
- Zhvillimi, monitorimi, menaxhimi i të dhënave dhe planet e mirëmbajtjes
- Vëmendje të veçantë duhet ndaj rishikimit të shpeshtë të kushteve të stacioneve matëse në lumenj
- Investime në mirëmbajtjen e përgjithshme të pajisjeve dhe telemetrisë
- Rritja e kontrollit të cilësisë për të gjitha të dhënat meteorologjike të prodhuara
- Publikimi i të dhënave për të rritur transparencën


EU Flood Protection Infrastructure Project - FPIP

Objektivi i përgjithshëm:

Për të forcuar gatishmërinë dhe parandalimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në Shqipërinë juglindore në përputhje me vlerësimin e nevojave pas përmbytjeve të Shkurtit 2015.

Rezultatet:

- I. Rehabilitimi i rreth 16 km infrastrukture lumore dhe kthimi në operacionalitet të plote të stacionit të hidro-pompimit në Akerni
- II. Studimi i vlerësimit mbi ndikimin social të përmbytjeve mbi grupet vulnerable i cili është shpërndarë tek autoritetet lokale.
- III. Raportet mbi rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe masat e adaptimit për një planifikim të përmirësuar territorial dhe zhvillim me qëndrueshmëri të integruar.
- IV. Vlerësimi i sistemeve hidro-ekologjike dhe socio-ekonomike të basenit të Vjosës
- V. Zhvillimi i një aplikacioni të Vlerësimit dhe Planifikimit të Burimeve Ujore (WEAP)



FALEMINDERIT